



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:008531  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05513399

**Ac.nr.8001/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen përmbartimore të kreditorës Merita Stublla - Emini, avokate nga Prishtina, Rruga “Ahmet Gashi”, Mati, H -II-, Nr.5, kundër debitorës L.A.K nga P..., Rruga “S.S”, p.n., lidhur me çështjen përmbartimore për borxh, në lartësi prej 2,200.48 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorës të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.793/20 i datës 25.02.2022, me datë 27.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET si e themeltë ankesa e debitorës L.A.K nga P..., Rruga “S.S”, p.n., NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.793/20 i datës 25.02.2022, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: APROVOHET i bazuar prapësimi i debitorës L.A.K nga P..., Rruga “S.S”, p.n., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 086/20 të datës 19.06.2020, të lejuar nga Përmbartuesja Private Rrezarta Metaj, në Prishtinë, dhe SHFUQIZOHET në tërësi Urdhri Përmbartimor, P.nr. 086/20 të datës 19.06.2020, i lejuar nga Përmbartuesja Private Rrezarta Metaj në Prishtinë, si dhe anulohen të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë çështje përmbartimore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin, PPP.nr.793/20 i datës 25.02.2022, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit L.A.K nga P... Rruga “S.S”, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.086/20 të datës 19.06.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj. II. OBLIGOHET debitori,

*që në rast të parashtrimit të Ankesës ndaj këtij Aktvendimi, ta paguaj garancionin në gjykatë në shumën prej 2,200.48€, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi. III. Në qoftë se pala ankuese dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, brenda afatit si në pikën -II- të këtij dispozitivi, ankesa e parashtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare nga pala ankuese”.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorja, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet ashtu që të aprovohet prapësimi, apo që aktvendimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditorja, në të cilën ka theksuar se ankesa e debitorës është në tërësi e pabazuar dhe i ka propozuar kësaj gjykate që ankesën e debitorës ta refuzon si të pa bazë, të mbetet në fuqi aktvendimi i ankimuar si dhe të vlerësohet nga kjo gjykatë, aktvendimi PPP.nr.793/2022 i datës 10.10.2022, me të cilin është liruar debitorja nga pagesa e garancionit, pasi që kreditorja pretendon se pa të drejt debitorja është liruar nga pagesa e garancionit.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe përgjigjen në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja ka paraqitur propozim për përmbartim pranë organit përmbartues me datë 19.06.2020, me arsye më konkretisht sikurse në propozimin e paraqitur.

Përmbartuesja Private, si organ përmbartues me urdhrin, P.nr.086/20 datës 19.06.2020, e ka lejuar përmbartimin.

Debitorjai pas pranimit të urdhrin për përmbartim, me datë 28.07.2020, ka paraqitur prapësim me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas prapësimit të debitorës, ka marrë aktvendimin, PPP.nr.793/20 i datës 25.02.2022, me të cilin e ka refuzuar prapësimin dhe ka vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar Gjykata ka vlerësuar se fatura e lëshuar nga kreditorit në bazë të cilës Përmbaruesja Private, e ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor, është dokument i besueshme në kuptim të Nenit 21, 29.1 nën paragrafi 1.3 të LPP-së, dhe përbënë bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore që të jetë e përmbarushme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim. Kjo për faktin se faturat e lëshuara nga kreditorja përmban të gjitha elementet e nevojshme në kuptim të Nenit 29.3 i LPP-së, kreditorin, debitorin, objektin, llojin, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit, është në origjinal dhe është e nënshkruara nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së parë, ka analizuar pretendimet e debitorës të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se debitorja nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës, si shkaqe të paraqitjes së prapësimin, andaj nuk i mori për bazë pretendimet e debitorës se e ka nënshkruar faturën nën shantazh, dhe se faturën e ka denocuar, pasi që në bazë të provave që gjenden në shkresa të lëndës, fatura është nënshkruar me datë 06.04.2020, fakt të cilin e pohon edhe debitorja, ndërsa denoncimi nuk nënkupton mos përmbushjen e obligimit. Andaj pretendimet e debitorës në këtë fazë të procedurës nuk janë relevante. Poashtu, gjykata e shkallës së parë konstatoi se debitori nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, dhe nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në pikën 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Me dispozitën e nenit 21 parashihet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Pra, në rastin konkret fatura lëndore, ka shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit, ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, Gjykata e Apelit vlerëson se është zbatuar gabimisht e drejta materiale për faktin se sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk mund të vihet në përfundim se dokumenti në bazë të cilit është propozuar dhe është lejuar propozimi për përmbuarim nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për tu përmbuar.

Me Nenin 27 paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Dokumenti përmbuarimor është i përshtatshëm për përmbuarim në qoftë se në të është treguar debitori dhe kreditori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata e Apelit gjatë shikimit të shkresave të lëndës vëren se propozimi për përmbuarim është bërë në bazë të faturës nr.04-20 të datës 06.04.2020. Fatura lëndore, në bazë të cilës është bërë propozimi për përmbuarim konsiderohet si dokument i besueshëm, siç përcaktohet me nenin 29 paragrafi 1 të LPP-së, mirëpo e njëjta nuk mund të konsiderohet si e përshtatshme për tu përmbuar për arsye se ashtu siç përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, është specifikuar shuma e detyrimit në dokumentin e besueshëm lëndor, por shumat e detyrimeve janë të përgjithësuara si: *“avansë për kryerjen e shërbimeve juridike”* dhe *“shërbime juridike shtesë përtej avansit”*. Në këtë procedurë siç dihet gjykata lëshohet vetëm në vlerësimin e dokumentit mbi të cilin është lejuar përmbuarimi, që në këtë rast Gjykata e Apelit, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuara përmbuarimi është i papërshtatshëm për përmbuarim sepse shumat e detyrimit të përshkruara në faturën lëndore janë të përgjithësuara siç u vlerësua më lart, andaj nga kjo rezulton se nga fatura lëndore nuk mund të vlerësohen se për cilat shërbime konkrete juridike është faturuar debitorja, nga kanë rrjedhur këto shërbime, prej ndonjë kontrate apo marrëveshje eventuale për secilin veprim, të ndërmarr nga kreditorja siç pretendon.

Titulli përmbuarues është ai mbi bazën e të cilit inicohet procedura e përmbuarimit dhe realizohet kërkesa e përmbajtur në të. Gjykata e Apelit vlerëson se në rrethana të tilla nuk ka pasur kushte ligjore të inicohet procedura e përmbuarimit dhe të lejohet përmbuarimi nga organi përmbuarues, kjo pasi që fatura lëndore në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbuarimore nuk është e përshtatshme për përmbuarim për derisa nuk janë të paraqitur në dokument mbi të cilin është lejuar përmbuarimi shërbimet e kryerja nga kreditorja sepse nuk do të thotë që një dokument vetëm duhet ta ketë shumën e përgjithshme të detyrimit për të qenë i përshtatshëm për përmbuarim pa e pasur burimin e faturimit. Më përgjigje në prapësim kreditorja i ka bashkangjitur disa lista në programin “Excel”, më përshkrimin siç pretendon kreditorja të shërbimeve të kryera ndaj debitorës, mirëpo as këto lista të bashkangjitura, nuk kanë pas ndikim që në këtë rast me vendos ndryshe sepse prej të njëjtave mund të konstatohet se cilat shërbime juridike janë faturuar nga kreditorja në faturën lëndore e cilat shërbime juridike janë paguar paraprakisht nga debitorja, për

këto arsye kjo gjykatë vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbarimi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore siç është përcaktuar me nenin 27 të LPP-së.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 208 dhe 209 par.1 , pika c) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.8001/2022 me datë 27.03.2024**

**Gjyqtari**

Adnan Konushevcu d.v.